Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

# KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Fillon Trajnimi i Regjistruesve për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos) 2024

25.03.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR) sot ka filluar etapën e fundit të trajnimeve për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos 2024).

Këto trajnime kanë qenë të parapara në katër nivele: 1) trajnimi i personelit të trajnuesve në ASK; 2) trajnimi për Komisionet Komunale (KKR): 3) trajnimi i mbikëqyrësve dhe që nga sot (25.03.2024) deri të

premten (29.03.2024) do te mbahet 4) trajnimi i regjistruesve, që janë përgjegjës për mbledhjen e të dhënave në terren.

Përveç stafi nga ASK (mbi 100 trajnerë dhe staf tjetër mbështetës), si dhe me mbështetje të komunave për kryerjen me sukses të trajnimeve, numri i pjesëmarrësve në këto trajnime është mbi 4 500 persona.

Trajnimi është planifikuar ta ketë pjesën teorike dhe praktike, ku rëndësi e madhe do t'i jepet pjesës praktike dhe përdorimit të sistemit për mbledhjen e të dhënave. Po ashtu, secili Regjistrues pas trajnimeve do ta ketë mundësinë e qasjes në video-animacion, ku përshkruhet i gjithë procesi si dhe qasje për mënyrën e plotësimit të fushave në pyetësor.

Java e fundit do të jetë e rëndësishme për shpërndarjen e pajisjeve, materialeve, vizita në Zonat Regjistruese (ZR) dhe për konsultime shtesë.